



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5164 Prot

Lezhë, më 11 / 5 /2023

VENDIM

Nr. 35, Datë 10 . 05 .2023

**“PËR
MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET PROGRAMIT
TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP) DHE BASHKISË LEZHË,
NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROGRAMIT “PËRMIRËSIMI I REZILENCËS SË
KOMUNITETEVE””**

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, Ligjit Nr. 9669/2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.5785 Prot., datë 06.07.2017 të nënshkruar ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Opera Life Onlus, Akt Marrëveshjes Nr. 3813 Prot., datë 13.06.2018 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operae Life dhe Bashkisë lezhë, si dhe draft Memorandunit të Mirëkuptimit Nr.4889 Prot., datë 03.05.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1. Miratimine Memorandunit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara Për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë, në kuadër të zbatimit të programit “Përmirësimi i rezilencës së komuniteteve”, në partneritet me organizatën jo-fitimprurëse “Të ndryshëm dhe të barabartë”, brenda territorit të Bashkisë Lezhë.
2. Vënien në përdorim të ambjenteve tëquajtura “Shtëpia Ola” (Qendra e Shëndetit të Grave dhe Fëmijëve), për zbatimin e projektit “Përmirësimi i rezilencës së komuniteteve” Brenda territorit të Bashkisë Lezhë, për periudhën Maj 2023 – Prill 2026.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
NDUE LULI



Prot 5164/
DT 17.5.23
10B



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 389/10 Prot.

Lezhë, më 16.05.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16, pika 2, gërma "b" të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 8 pika 2, neni 29 pika 1, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr.121, datë 24.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", ligjin 22/2018 "Për strehimin social", ligjin nr.9669/2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar, ligjin nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.35, datë 10.05.2023, të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë, në kuadër të zbatimit të programit "Përmirësimi i rezilencës së komuniteteve".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

